



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 10.08.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim terreni sportiv në Shënvlash”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime ndërtimi për struktura për terrene sportive 45212221-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

24,999,057.50 (njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) Lek pa TVSH.

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.187, datë 21/05/2026, me Nr.7093 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumentet sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në baze të urdhrit Nr.187, datë 21/05/2026, me Nr.7093 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në VKM nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 24,999,057.50 (njëzet e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 16 (gjashtëmbëdhjetë) javë ose 112 (njëqind e dymbëdhjetë) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Ndërtim terreni sportiv në Shënlash”. Ky objekt kërkon

financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së Ndërtim terreni sportiv në Shënvllash, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare 2023, 2024, 2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteri është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.187, datë 21/05/2026, me Nr.7093 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpallje së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar*

kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumn e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1 A** Punime gërmimi në tokë.
- NP – 4 B** Rrugë, austostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP – 12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS – 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS – 6 A** Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS – 9 A** Punime strukturore speciale.
- NS – 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.
- NS – 18 A** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kerkua	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese	Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorine respektive	Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese
NP-1	Punime gërmimi ne toke.	3.47/1b Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme 3.98/b Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.87/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	A 1,253,574.20 lekë	0 ÷ 20 milion
NP – 4	Rruge, austostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	3.212 Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri 3.212/b Shtrese stabilizant t=10cm 3.706 Mbushje me zhavorr ne trupin e rruges, perhapur me makineri (me ngjeshje cdo 20 cm) 3.222/2 Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri 3.226/1 Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	B 22,142,600.35 lekë	21 ÷ 50 milion

		2.262/4 Shtrese betoni C 16/20 m3 2.262/4 Shtrese betoni C 16/20 m3 3.287 F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm 5. PUNIME TE NDRYSHME 3.643/a F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber) 3.643 Mbjellje bari ne skarpat 3.620 Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka 3.654/1 F.V. Tuba plastmasi ø 80 1.29/1 Beton C16/20 (Me cakell) An1 Shtrese gome 1.2 cm + primer An2 Shtrese tartani fusha basketbollit An3 Tabele kosha fushe basketball An4 Loje Kombinat kacavjere/ lekundes Lisharese me 2 vend/rreshkitese me 2 vend. Konstruksion metalik me pjekje ral + konstruksion plastik+rrjete litar lini + shkalle Anan4 Lekundese me 2 vende me konstruksion metalike An5 . Loje rrotulluese me 6 vende me konstruksion metalike me bosht qendror rrotullues An6 Suste per femije An7 Tub HDPE Ø200 An8 Tub HDPE Ø250 SN8 An9 Kunet+zgarë		
NP – 12	Punime te inxhinierise se mjedisit	Perfshin ne menyre te thjeshtuar procesin e riaftesimit natyror, konservimin dhe riaftesimin e terrenit te perdorur. Veprat per rivegjetizimin e zones ku eshte parashikuar ndertimi i objektit,gjelberimi, etj. 3.643/a F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber) 3.643 Mbjellje bari ne skarpat	A 152,722.80 lekë	0 ÷ 20 milion
NS – 1	Punime per prishjen e ndertimeve	2.426/3 Prishje shtresa betoni	A 11,496.13 lekë	0 ÷ 20 milion

NS - 6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	3.945/2 Vijezi shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 30 cm. Akrelike	A 11,496.13 lekë	0 ÷ 20 milion
NS - 9	Punime strukturore speciale	2.181 F.V. Konstruksione metalike te perbera	A 494,215.05 lekë	0 ÷ 20 milion
NS – 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	3.164/1t F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm 3.176 F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 3.169 F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm 3.174 F.V. Krah dy degesh per shtylla metalike 3.168 F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10 3.175 F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250Ë GG FAE 44004, me llampe 250Ë 230V 3.170 F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm 2.463 F.V. Ndricues projektor me llampe SAP-T 250ë 2.490 F.V. Kuader ndriçimi 2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m 4.131/3.5 F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm2 An10 F.V.Kabell cu FROR 3 x 4mm2 ,tokezimi te perseritur. An11 F.V.Kabell cu FROR 3x 2.5mm2	A 1,016,104.17 lekë	0 ÷ 20 milion
NS – 18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i punimeve topogjeodezike ne objekte inxhinierike.	A	0 ÷ 20 milion

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi/ Strukturist 1 (një)

b. Inxhinier Ndërtimi/ Transport	1 (një)
c. Inxhinier Gjeodet / Topograf	1 (një)
d. Inxhinier Mjedis	1 (një)
e. Inxhinier Elketrik	1 (një)

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës , kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e

Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi/transport</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore dhe infrastrukturore të fushës, referuar preventivit të punimeve (Punime ndërtimi, Germimi, Prishje), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-4, NS-1, NS-6</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi/Strukturist</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në ndërtim punime më komplekse sic janë e konstruksioneve metalike të përbëra, të cilave i korrespondon kategoria NS-9. Gjithashtu inxhinieri strukturist do të shërbejë për të gjitha problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit për përfundim të terrenit nëse do të dali si problem pas punimeve të gërmimeve</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Mjedis</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Mjedisore, referuar në preventivin e punimeve si dhe në bashkëpunim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP12.</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Elektrik</i>	<i>Eshtë përgjegjës për punimet e rrjetit të brendshëm elektrik dhe telefonisë, të cilave i korrespondon kategoria NS-14.</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen, të cilave i korrespondon kategoria NS-18.</i>

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesë të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë për sipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga

subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- a. 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. 1 (një) inxhinier, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit” lëshuar nga autoritetet të akredituara përgjegjëse shtetërore.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, bazuar në përllogaritjen e orëve të punës, kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve, të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa më shpejt të objektit.

- **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këtë kontratë ku dhe nëmuri i punonjësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

- **Inxhinieri, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit**” lëshuar nga autoritetet e akredituara përgjegjëse shtetërore. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve që parashikohen të realizohen në objekt, të cilat përfshijnë shtresa nënshtrese dhe mbishtrese, punime betoni dhe betonarmeje, materiale agregate, elementë metalikë, si dhe shtresa sportive me kërkesa specifike teknike. Për të garantuar që materialet e përdorura gjatë zbatimit të punimeve janë në përputhje me specifikimet teknike të projektit, standardet shqiptare dhe europiane në fuqi, si dhe për të siguruar kontrollin e cilësisë së tyre gjatë gjithë procesit të ndërtimit, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel teknik të kualifikuar dhe të certifikuar në fushën e testimit dhe vlerësimit të performancës së materialeve të ndërtimit. Prania e këtij specialisti garanton verifikimin dhe interpretimin profesional të rezultateve laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt, duke minimizuar rrezikun e përdorimit të materialeve jo konformë dhe duke siguruar realizimin e veprës sipas parametrave të kërkuar të cilësisë, qëndrueshmërisë dhe sigurisë.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar **mjekun** e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) teknike ndërtimi
- 1 (një) teknik topograf
- 1 (një) elektrikist
- 2 (dy) përgatitës të konstruksioneve metalike
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) betonues
- 2 (dy) hekurkthyes

- 5 (pese) specialiste për shtrim pllaka trotuari
- 2 (dy) asfaltoshtrues
- 2 (dy) saldator
- 3 (tre) shofer për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe certifikate e aftësisë profesionale (CAP), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.
- 23 (njëzet e tre) punëtorë të thjeshtë

Punonjës Manovrator

- 2 (dy) Eskavatoristë
- 2 (dy) Automakinist

Për punonjësit e specializuar/të kualifikuar e mësipërm, Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune të vlefshme;
- Diplomë profesionale, certifikatë ose dokument tjetër që provon kualifikimin profesional, lëshuar nga institucione të licencuara sipas legjislacionit në fuqi ose ekuivalente;
- Certifikatë të sigurimit teknik, të lëshuar nga subjekte të akredituara nga DPA ose organizma ekuivalentë ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, kur kërkohet sipas profilit të punës.

Për punonjësit shoferë duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Leje drejtimi e vlefshme;
- Certifikatë e aftësisë profesionale ose patentë manovrimi e lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur shoferët janë të kontraktuar për mjete e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për manovratorët/automakinistët duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Dëshmi aftësie profesionale për përdorimin e makinerive të rënda, sipas legjislacionit në fuqi dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Në rastin kur manovratorët janë të kontraktuar për mjete e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Për punëtorët e thjeshtë duhet të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre prej 16 javë. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, siç janë gërmimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e nuraturës etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punëtorët dhe ndjek ecure e tyre gjatë kohës së punës. Tekniku duhet të disponojë Diplome e shkollës mesme.
- **Tekniku topograf** është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë matjeve topogjeodezike të terrenit sportiv që do të ndërtohet.
- **Elektrici** është i nevojshëm për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve, ku volumi me i madh i punimeve elektrike. Elektrici duhet të disponojë Certifikatë Trajnimi / Diplome.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Karpentierët duhet të disponojë Certifikatë

Trajnimi / Diplome.

- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit. Numri i kërkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Hekurkthyesi duhet të disponojë *Certifikate Trajnimi / Diplome.*
- **Saldator** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimin të konstruksioneve të përbëra metalike.
- **Përgatitës të konstruksioneve metalike**— është i nevojshëm për realizimin e punimeve të konstruksioneve të përbëra metalike sipas zërave të preventivit
- **Specialist për shtrim pllaka trotuari**— është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave dhe punimet e tjera që lidhen me to sipas zërave të preventivit.
- **Betonuesit**: janë të nevojshëm për punimet e betonit sipas zërave të preventivit.
- **Asfaltoshtruesit** janë të nevojshëm për punimet e shtresave asflatike sipas zërave të preventivit.
- **Manovratori eskavatorist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit si eskavator gjurmimi dhe fadroma të të gjitha llojeve, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të renda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhrin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës përcaktohet:

Makineritë e renda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të renda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës përcaktohet: Makineritë e renda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.

- **Shofer** pajisur me *Certifikate Aftësimi Profesional* nevojitet për manovrimin e automjeteve të transportit, referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve

Certifikata e Aftësimit Profesional (CAP), është një kualifikim që vërteton aftësinë profesionale të drejtuesve të mjeteve rrugore që pajisen me leje drejtimi të kategorive C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D dhe DE.

- Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin të objekti.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht prej 60 (gjashtëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b.** Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Numri prej 60 punonjës përfshin 23 punëtorë të thjeshtë + 37 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjete, manovratore etj përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për

ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 60 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar ne katër elementet e strukturës se kostos (material, punëtori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
2	Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5- 5 ton	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
3	Autovinc min 5 ton	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
4	Minieskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1(një) copë	Ne pronesi ose me qira
5	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
6	Dumper kantieri 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
7	Greider	1 (një) copë	Në pronësi ose me qira
8	Asfaltoshtruese	1 (një) copë	Në pronësi ose me qira
9	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
10	Autobitumatriçe	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
11	Rul ngjeshes hekur gome mbi 20 ton	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
12	Rul asfalti gome gome deri 6 ton	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
13	Autoberoniere	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira

14	Autopompe betoni	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
15	Autobetoniere me kapacitet mbajtes 2-4 m3 (mjet teknologjik me goma)	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
16	Rimorkiator per transportin e makinerive min 20 ton	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
17	Tokmak Elektrik	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
18	Autobot uji	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
19	Gjenerator mbi 100 këa	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
20	Elektro saldatrice	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
21	Tranxhe hekuri/kthyese hekuri	2 (dy) copë	Ne pronesi ose me qira
22	Makineri per shtrese tartani (mixer, paisje fryrese, aksesori)	1 (një) copë	Ne pronesi ose me qira
23	Fabrike asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III. 1 .B)	1(nje) copë	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi
24	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1(nje) copë	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi

- Pajisje te tjera ndihmese, (te cilat duhet te vërtetohen me deklaratë sipas shtojcës përkatëse, te DST:

- | | |
|--|-------------------------|
| 1. Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi | 60 (gjashtëdhjetë) copë |
| 2. Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi | 2 (dy) copë |
| 3. Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi | 5 (pesë) copë |
| 4. Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi | 10 (dhjetë) copë |

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: *Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve në kantier në të cilët është e shpërndarë puna objekt prokurimi. Gjithashtu koha e realizimit të punimeve prej 16 javësh.*

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"¹ në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kërkohet që operatorët ekonomike t'i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njësi është bazuar tek zërat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkojnë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuar nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet

teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

- **Mjetet kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina** janë kërkuar për transportin e dherave apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për transportimin e tubacioneve dhe rakorderive që do të furnizohen me qëllim realizimin e veprës. Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Ky numër është i nevojshëm në raport edhe me vëllimin e materialeve.
- **Mjetet eskavator me goma, minieskavator, makineri gjërmimi për hapësira të ngushta, fadroma**, janë kërkuar për punimet si gjërmime kanalesh, gjërmim sistemi drenazhit, gjërmime dheu, sisteme, etj gjatë zbatimit të projekt preventiv. Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gjërmimeve të dheut, nevojitet përdorimi i eskavatorëve dhe minieskavatorëve për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet.
- **Autobetoniere, betoniere, autopome betoni**, janë kërkuar për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me betonin dhe beton arme me qëllim ruajtjen e markës së betonit sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se transportimi i betonit, kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv, janë kërkuar këto mjete.
- **Mjetet Grejder (mjet teknologjik), Rrule gjeshës, Asfaltoshtruese dhe Autobitumetrice, Autobot uji** do të përdoret në momentet e ndërtimit të shtresave të ndryshme që do të realizohen në kantierin e veprës. Kjo makineri është e domosdoshme për të siguruar zbatimin e shtresave dhe neshtresave të objektit sipas specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit.
- **Paisjet Tranxhe** për përpunimin e hekurit të ndërtimit, Motogjenerator do të përdoren për punime të ndryshme në objekt sipas projekt preventiv. Këto pajisje janë të domosdoshme gjatë zbatimit të projektit në kohë dhe me cilësi.
- **Ndërsa mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë** të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”

1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	Janë të nevojshme për transportin e materialeve të ndryshme të dala nga gjërmimet apo materialet që do importohen në objekt
2	Kamioncina me kapacitet mbajtës deri në 3.5- 5 ton	Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme dhe transport punonjësish.
3	Autovinc min 5 ton	Eshtë i nevojshëm për ngritje materiale të ndryshme në kantier si konstruksionet e perbera për ndërtimin e fushes . I nevojshëm për shkarkimin e ngarkesave të rënda si tubacionet , zgarat metalike , paneleve ,
4	Minieskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Eshtë i nevojshëm për hapjen e kanaleve dhe gjërmime të ndryshme në kantier

5	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	<i>Eshte i nevojshem per ngarkimin e materialeve te ndryshme ne kamioncina, dhe spostimin e materialeve te ndryshme ne rruge</i>
6	Dumper kantieri 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	<i>janë automjete të rënda të projektuara për të transportuar materiale të lirshme dhe të rënda (si dheu, rëra, zhavorri apo mbetjet) në terrene të vështira. Këto makineri janë thelbësore për punimet e dheut dhe ndërtimin e rrugëve.</i>
7	Greider	<i>Eshte i nevojshem per hapjen e materialeve si cakull e stabilizantit ne trupin e fushes</i>
8	Asfaltoshtruese	<i>E nevojshme për shtrimin me asfalt</i>
9	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	<i>Eshte i nevojshem per germim ne trupin e fushes dhe hedhjen e materialeve ne mjete transportuese</i>
10	Autobitumatrice	<i>është një kamion i specializuar që përdoret në ndërtimet rrugore për shpërndarjen e barabartë të bitumit ose emulsionit të bitumit në shtresat e rrugës përpara se të hidhet asfalti</i>
11	Rul ngjeshes hekur gome mbi 20 ton	<i>Eshte i nevojshem per ngjeshjen e stabilizantit i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,</i>
12	Rul asfalti gome gome deri 6 ton	<i>Eshte i nevojshem per ngjeshjen e binderit dhe asfaltit</i>
13	Autoberoniere	<i>e nevojshme per per punimet e betonimit</i>
14	Autopompe betoni	<i>e nevojshme per per punimet e betonimit</i>
15	Autobetoniere me kapacitet mbajtes 2-4 m3 (mjet teknologjik me goma)	<i>Eshte i nevojshem per per gatitjen dhe betonit ne sasira te vogela ne objekt</i>
16	Rimorkiator per transportin e makinerive min 20 ton	<i>Eshte i nevojshem per transportin e mjeteve ne kantier</i>
17	Tokmak Elektrik	<i>I nevojshëm për punimet e ndryshme ngjeshjen e shtresave</i>
18	Autobot uji	<i>Për furnizimin me ujë në vepër gjatë punimeve</i>
19	Gjenerator mbi 100 këa	<i>Për furnizimin me energji elektrike në vepër</i>
20	Elektro saldatrice	<i>Për punimet e saldimit të kontruksioneve metalike</i>
21	Tranxhe hekuri/kthyese hekuri	<i>Për pregatitjen e armaturës së hekurit</i>
22	Makineri per shtrese tartani (mixer, paisje fryrese, aksesor)	<i>Për realizimin e punimeve të shtrimit të shtresës tartan</i>
23	Fabrike asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III. 1 .B)	<i>Për të siguruar furnizim me material asfalt në vepër</i>
24	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	<i>Për të siguruar furnizim me beton në vepër</i>

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencë lëshuar nga QKL: “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”, “Kodi III.2.B”, së bashku me aktin e miratimit.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” së bashku me aktin e miratimit dhe kodet **17 05 04, 17 09 04** në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar si dhe Vendimit Nr. 402, datë 30.6.2021 “PËR MIRATIMIN E KATALOGUT TË MBETJEVE”.

Argumentimi: *Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu.), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, dhe kryerjen e transportit të tyre në vend depozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Sipas VENDIM Nr. 402, datë 30.6.2021 “PËR MIRATIMIN E KATALOGUT TË MBETJEVE” kodet e sipërcituara lidhen ngushtë me preventivin dhe natyrën e objektit si më poshtë:***

- **17 05 04** Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 (17 05 03 * Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme)
- **17 09 04** Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03 (17 09 01 * Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë merkur, 17 09 02 * Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB, 17 09 03 * Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përmbajnë substanca të rrezikshme).

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- b. Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- c. Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune”, ose certifikatë me standardin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- d. Certifikatë ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim” ose Certifikatën e përditësuar Certifikatë ISO 3834-2:2021, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zërave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: *Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-se Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçante, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qellim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës presë kohe do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.*

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatorë, si dhe synon të rrisë

kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatorë si dhe meqenëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jene në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatet ofertues të jene të pajisur me këtë standard cilësie.

- *Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: Parandalimin e dëmtimit të mjedisit; Vlerësim të aspekteve mjedisore; Përmirësimin e vazhdueshëm; Respektimin e legjislacionit vendas dhe shmangien e gjobave; Ruajtjen e burimeve natyrore dhe reduktimin e kostos; Përmirësimin e imazhit të organizatës në publik; Përmirësimin e komunikimit me autoritetet.*

- *Për ISO 45001:2018: Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një instrument organizativ që lejon menaxhimin në mënyrë organike dhe sistematike të sigurisë në punë, duke theksuar kërkesat e mëposhtme: Adoptimi i një politike për menaxhimin e sigurisë; Identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i tyre, identifikimi i metodave të kontrollit, të lidhura ngushtë me rregullat ligjore ose masat e tjera; Përkufizimi i programeve dhe objektivave specifike duke zbatuar logjikën e Planit-Do-Check-Act;*

- *Certifikatë ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim” ose Certifikatën e përditësuar Certifikatë ISO 3834-2:2021, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës është në përputhje me objektin e prokurimit e cila lidhet me në fushën e veprimit siç janë konstruksionet metalike, saldimet e tyre e tubacioneve etj. Ky standard përcakton kërkesat gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike si në punishte ashtu edhe në vendet e instalimit në terren.*

2.4.3 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- **Pllaka trotuari**
- **Shtrese Tartani**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a. Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të deponimit të

autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- b. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standardeve të miratuara.*

Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standardeve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që materialet kryesore të jenë sipas standardeve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentet e tenderit.

2.4.4 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesin grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 16 javë ose 112 ditë kalendarike **dite pune nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë me **një laborator testimi të betonit**, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve dhe punimeve që do të realizohen në objekt. Referuar projektit dhe preventivit të punimeve, objekti përfshin punime betoni dhe betonarmeje, të cilat kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së materialeve gjatë zbatimit të kontratës. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të sigurojë kryerjen e provave laboratorike për betonin e freskët dhe betonin e ngurtësuar, sipas standardeve teknike në fuqi, me qëllim verifikimin e parametrave të rezistencës, qëndrueshmërisë dhe përputhshmërisë me specifikimet teknike të projektit. Disponimi i një kontrate me laborator të akredituar garanton që gjatë zbatimit të punimeve do të kryhen kontrollet dhe testimet e nevojshme laboratorike, duke siguruar përdorimin e materialeve cilësore dhe realizimin e veprës në përputhje me kërkesat teknike, standardet e ndërtimit dhe kushtet e kontratës.

Kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e kontratës, pasi testimi laboratorik i betonit përbën një element thelbësor të kontrollit të cilësisë për punimet e betonit dhe betonarmesë të parashikuara në preventiv.

SSH EN 12350-2:2019: Përcakton metodën e provës për testimin e betonit të freskët duke përdorur rrjedhjen (**Slump-test**), i cili mat punueshmërinë dhe konsistencën e masës.

SSH EN ISO 6892-1:2019: Përcakton parimet për **testimin në tërheqje të materialeve metalike** (si p.sh. hekuri i betonit që përdoret për armaturë) për të përcaktuar kufirin e elasticitetit dhe rezistencën në tërheqje

SSH EN 12390-8:2019: Përcakton thellësinë e **depërtimit të ujit nën presion** të betonit i ngurtësuar, duke treguar qëndrueshmërinë e tij ndaj ujit dhe lëngjeve të tjerat që do të furnizohen”

2.4.6 Çdo ofertues duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** për punimet në objekt.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur dhe në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe bazuar në VKM nr. 312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë në kantiere të përkohshme ose të lëvizshme". Kjo VKM, e nxjerrë në zbatim të nenit 42 të Ligjit nr. 10237/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", parashikon shprehimisht se plani i sigurisë dhe i koordinimit hartohet në bazë të kriterëve të aneksit VI dhe është pjesë përbërëse e kontratës së prokuruar.*

Shënim: Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qenë se këto kriterë janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha normat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standardeve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit DPS, në ato raste kur këto standarde janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); dhe nenit 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), grupi i punës, i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor, hartoi Specifikimet Teknike për realizimin e objektit: "Ndërtim Terreni Sportiv në Shënvllash", duke përcaktuar qartë kërkesat teknike, materialet, standardet dhe metodat e zbatimit që duhet të respektojë operatori ekonomik fitues, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme, sipas nenit 3 dhe nenit 36, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020.

Specifikimet Teknike janë hartuar bazuar në Metodën Standarde të Matjeve të Ndërtimeve Civile, dhe referojnë normat dhe standardet teknike në fuqi, duke garantuar cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e veprës, në funksion të natyrës dhe vlerës së kontratës.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit